



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI

Nr. 307 Prot

Fushe- Arrez 24 / 2024

P/VENDIM
Nr. 27 datë. 24 / 10 / 2024

“Për

ndarjenë dhe përdorimin e fondit të kushtëzuar të Emergjencave Civile për , ndërhyrjen emergjente në rikonstruksionin e rrugës auto të fshati Dardhë Njesia Administrative Blerim, rikonstruksionin e murit mbajtës pranë Çerdhës së femijeve Fushe-Arrez dhe blerje paisjesh për MZSH-në.

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, neni 29, Ligjit nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, Ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, neni 30, shkronja “gj”, VKM nr. 414 datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të Buxhetit të shteti për Mbrojtjen civile”, si dhe VKM Nr. 290 datë 17.05.2023 “Për një ndryshim në Vendimin Nr. 414 date 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të Buxhetit të shteti për Mbrojtjen Civile” si dhe në kerkesen Nr. Extra datë 13.09.2024 të Njesisë Administrative Dardhe “Kërkesë për ndërhyrje në rrugën auto rurale Dardhë” dhe në kerkesen e Drejtorisë së Shërbimeve Fushe- Arrez Nr.2709 Date 28/08/2024 “Kërkesë për ndërhyrje urgjente në rikonstruksionin e murit pranë Çerdhës së femijeve Fushe-Arrez” si dhe në kerkesen e MZSH-se për blerje paisjesh:

Spektori i Emergjencave Civile, i Financës dhe Kryetari i Bashkisë,

Propozojnë:

1. Shpërndarjen e fondeve me kod produkti 91707AG nga programi 10910 në vlerën, **1 000 000** (nje milion leke), me objekt “Devijim i e rrugës auto fshati Dardhe, Njesia Administrative Blerim për shkak të rreshqitjes të demtuar nga shirat e rënë me datë 06.09.2024, në territorin e Bashkisë Fushe-Arrez”, nga fondi i emergjencave civile e cila sistemohet në grup, titull, kapitull dhe artikull 17-10910-01-604 shuma prej **1 000 000** (nje milion leke)
2. Shpërndarjen e fondeve me kod produkti **91707AG** nga programi 10910 në vlerën, **400 000** (katerqind mijë leke), me objekt “Ndertim muri mbajtës Çerdhja e femijeve Fushe-Arrez”, nga fondi i emergjencave civile e cila sistemohet në grup, titull, kapitull dhe 17-10910-01-604 shuma prej **400 000** (katerqind mijë leke), leke
3. Shpërndarjen e fondeve me kod produkti **91707AG** nga programi 10910 në vlerën, **884352** (teteqind e tetëdhjetë e kater mijë e treqind e pesëdhjetë e dy), me objekt “Blerje paisjesh për MZSH-në”, nga fondi i emergjencave civile e cila sistemohet në grup, titull, kapitull dhe artikull 17-10910-01-604 shuma prej **884352** leke

4. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Drejtoria e Sherbimeve Publike, Sektori Emergjencave Cicile dhe i Finances, Njesia e Prokurimeve Publike.

Përgj. i Sektorit të E. Civile

Përgj. Finances

KRYETAR

Ing. Dod PEPA

Dritan LIKA

Hil CURRI





REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ

Tel:027123131,email:bashkiafushearrez@hotmail.com

Fushe-Arrez me 24.09.2024

LENDA: Relacion mbi përdorimin e fondit të emergjencave me objekt:
Për ndarjenë dhe përdorimin e fondit të kushtëzuar të Emergjencave Civile për, ndërhyrjen emergjente në rikonstruksionin e rrugës auto te fshati Dardhe Njesia Administrative Blerim, rikonstruksionin e murit mbajte prane Çerdhes se femijeve Fushe-Arrez dhe blerje paisjesh per MZSH-në.

Drejtuar: Keshillit te Bashkise Fushe-Arrez

- 1- Si pasoje rreshjeve te shumta te shiut te rena ne territorin e Bashkise Fushe-Arrez me dt.06.09.2024 ka rrëshqitur komplet trupi i rrugës auto-rurale në fshatin Dardhë Njësia Administrative Blerim duke u bërë e pariparueshme, ndaj është e domosdoshme të devijohet dhe të vihet në funksion sa më shpejt të jetë e mundur. Menjehere grupi i punes konstatoi situaten e krijuar ne terren dhe parashikoj qe per venien ne funksion te kësaj rruge është e domosdoshme devijimi i saj pasi riparimi i segmentit ekzistues është i pamundur në kushtet e terrenin ekzistues. Për këtë nevojiten angazhimi i mjeteve te renda te mundshme te zones si dhe mjetet qe ka bashkia ne dispozicion. Bazuar ne preventivat perkates për këtë segment rruge konstatohet qe është e domosdoshme ndërhyrja sa më shpejt të jetë e mundur. Per rivenien ne funksion te kësaj rruge auto –rurale nevojitet vlera e perafert prej **1 000 000 (një milion) lekë.**
- 2- Kemi demtimin e murit tek Çerdhia e femije Fushe-Arrez, ku nje pjese e tije eshte shembur totalisht duke rrezikuar edhe godinen e Çerdhes, pasi muri ne fjale eshte ngjitur me objektin, dhe demtimi ka ardhur si pasoj e amortizimit dhe e shirave te here pas hershme dhe mungeses se nje tubi shkarkim te ujrave siperfaqsores qe vine nga qatija e Çerdhes duke u bere shkak per shembjen e tije. Grupi i punes pas konstatimit ka hartuar edhe preventivin per rikonstruksionin e tije ku vlera e plote e investimin shkon **400 000 (katerqind mije leke)**
- 3- Duke pare nevojat qe sektori I MZSH-se ka per paisjen me mjete pune lidhur me raste te ndryshme qe eshte perballur per sa perkes shuarjes se zjarreve dhe nderhyrjeve ne aksidente I nevoiten keto paisje:

Pompo ujte gjenerator qe punon ne thithje dhe shtytje 2 polshe

Gjeneratot 4-6 kilovat

5 Radio komunikimi

2 Gure fresibla

Gersher hidraulike per aksidentet dhe uniforma dhe kepuce per stafin.

10 Qanta shpine, qe per blerjen e ketyr duhen **884352 (teteqind e tetedhjetë e kater mije e treqind e pesedhjet e dy) leke.**

Per te mundesuar perdorimin e kesaj vlere duhet te perdorim fondin e kushtezua te Emergjencave Civile i cili eshte 2284352 leke me kod produkti 91707AG I cili eshte idestinuuar per tu perdorur per "Shpenzime per marrjen e masave parandaluse, lehtesuese mbrojtese dhe rehabilituese ne objekte te ndryshme, blerjes se materjaleve dhe sherbimeve te ndryshme per mbrojtjen e jetes dhe te prones se njerzve", dhe me vone do te vazhdohet me procedurat standarte te prokurimeve sipas legjislacionit ne fuqi.

Zyra Emergjeca Civile

Përgjegjës i Sektorit

Ing. Dod PEPA



Specialist

Nezir AHMETAJ



Specialist

Silvio Pashkaj



Miratoi

Kryetari

Hil CURRI

